



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr.1617, date 24.06.2011

Për

“Miratimin e Rregullores : “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndërrurbane të Komunikimeve Elektronike ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | |
|---------------------------|---------|
| 1. Z. Piro Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Rregullores : “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike ndërrurbane të Komunikimeve Elektronike” dhe qëndrimin e AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara në konsultimin publik.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 7, 8, 20, 21, 110, 114 dhe neni 115 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”(ligji 9918).
2. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;

3. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni shoqërues i projekt vendimit;
- Rregullore : “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndërrubane të Komunikimeve Elektronike ”
- Komentet e dhëna mbi projekt-rregulloren nga palët e interesuara gjatë periudhës së konsultimit publik.

V Ë R E N:

1. AKEP, në zbatim të neneve 20,21 të ligjit 9918 harton rregullat këto kushte teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore dhe fibrave optike. Këto rregulla ju vijnë në ndihmë sipërmarrësve për ndërtimin e rrjeteve kabllore urbane dhe ndërubane të komunikimeve elektronike sipas disa kushteve të caktuara teknike.
2. Rregullorja e hartuar përcakton kushtet teknike për ndërtimin e rrjeteve kabllore urbane dhe ndërubane të komunikimeve elektronike, pa u futur në kushtet teknike të vete rrjeteve të komunikimeve elektronike.
3. Duke qenë se projekt-rregullorja konsiderohej e rëndësishme në aspektin rregullator ky dokument iu nënshtrua procesit të konsultimit publik për periudhën 15.03.2011 deri më 14.04.2011.
4. Gjatë periudhës së konsultimit publik janë paraqitur komente nga Ministria e Brendshme, MITIK, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Vodafone Albania, AMC dhe Albtelecom .
5. Rregullorja e paraqitur reflekton disa ndryshime në bazë të komenteve të dhëna.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenin 114, pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, germën (c) të nenit 7/1, pikën 2 të nenit 17 të ligjit 8530 i ndryshuar si dhe pikën 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë Rregulloren : “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndërrbane të Komunikimeve Elektronike ”. (bashkëngjitur)

2. Ky vendim te publikohet ne faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE